

Kursimi dhe planifikimi hap pas hapi

AL

Projekti P.A.S.S.O.
Programe për Autonomi, Zhvillim dhe Mbështetje në Punësim

Përmbajtja

- 1** **Hyrje**
- 2** **Paratë, bankat dhe sistemet e pagesave**
- 3** **Menaxhimi i kursimeve dhe gjurmimi i tyre**
- 4** **Planifikimi financiar**
- 5** **Investimet**
- 6** **Sigurimet dhe pensionet**
- 7** **Përfundime**





Paratë shpesh konsiderohen si **një mjet**. Ne i përdorim për të bërë blerje, për të paguar qiranë, për të blerë gjërat që na duhen çdo ditë dhe i marrim si pagesë për punën tonë. Por paratë janë shumë më tepër se kaq: ato lidhen me **mundësitë** që mund të kemi në jetën tonë.

Në fakt, paratë mund të:


- Ndikojnë në ndjenjën tonë të stabilitetit dhe pavarësisë.
- Të hapin dyer për mundësi të reja, si arsim, punë, strehim dhe aktivitete sociale.

Ky toolkit është krijuar për t'u ofruar personave migrantë dhe azil kërkues mjete të dobishme për të marrë vendime të informuara dhe për t'u ndjerë më të sigurt në menaxhimin e parave të tyre. Në këtë rubrikë do të shpjegojmë konceptet më të rëndësishme të **edukimit financiar**.

Menaxhimi i parave në një vend të ri mund të jetë më kompleks: sisteme bankare të ndryshme, rregulla të reja, kontrata, kosto të papritura dhe përgjegjësi familjare midis vendit të origjinës dhe vendit ku jeton tani. Të kesh informacione të qarta dhe mjete të përshtatshme të ndihmon të shmangësh rreziqet, të planifikosh të ardhmen dhe të forcosh autonominë tënde ekonomike, hap pas hapi.

2 Paratë, bankat dhe sistemet e pagesave

Çfarë janë paratë?



Paratë nuk janë vetëm diçka që përdorim për të blerë mallra dhe shërbime.

Ato kanë katër funksione kryesore:

- **Mjet shkëmbimi:** përdoren për të paguar dhe për të marrë pagesa.
- **Ruajtës vlere:** lejojnë ruajtjen e pasurisë me kalimin e kohës (kursime).
- **Njësi matjeje:** shërbejnë për të matur vlerën e gjërave (çmimet, pagat).
- **Instrument social dhe besimi:** funksionojnë sepse njerëzit kanë besim te sistemi që i rregullon (shteti, bankat, komuniteti).

Në çdo vend sistemi financiar mund të funksionojë në mënyra të ndryshme. Prandaj është e rëndësishme të kuptosh se si funksionon ai në Itali dhe në Evropë.

Diferenca midis parave në dorë, Bankave formale dhe Sistemeve informale

Paratë në dorë

(kartëmonedhat)

Janë **para fizike** që mund t'i mbash në dorë.

Avantazhet:

- Të lehta për t'u përdorur
- Nuk kërkojnë llogari bankare ose dokumente
- Të dobishme për shpenzime të vogla të përditshme

Kufizimet:

- Nuk janë të gjurmueshme
- Nuk ndihmojnë në krijimin e një "historiku financiar"
- Mund t'i humbasësh ose mund të të vidhen

Sistemet financiare informale

Janë mënyra jozyrtare për të menaxhuar kursimet dhe huatë, të bazuara në besim dhe marrëdhënie komunitare.

Shembuj:

- Tontine ("Short") / ROSCA ("Fond i përbashkët"): një grup njerëzish kontribuon rregullisht me një shumë parash; me radhë një person merr të gjithë shumën.
- Hawala ("Leke me dore"): sistem transferimi parash përmes rrjeteve të besimit, pa përdorur bankën.

Kujdes!

- Më të aksesueshme dhe më të shpejta
- Por kanë më pak mbrojtje ligjore
- Nëse diçka shkon keq, është e vështirë të rikuperosh paratë

Bankat formale (Itali / BE)

Bankat formale janë banka zyrtare, të kontrolluara nga shteti italian dhe Bashkimi Evropian.

Avantazhet

- Paratë ruhen në mënyrë të sigurt
- Mund të marrësh pagën
- Mund të marrësh ndihma publike
- Mund të paguash qira, fatura dhe taksa
- Paratë janë të gjurmueshme (e dobishme për kontrata pune ose kërkesë për kredi)

Kufizimet

- Mund të ketë kosto (tarifë mujore, komisione)
- Banka mund të kontrollojë lëvizjet e parave (ligji kundër pastrimit të parave)
- Pa një leje qëndrimi të vlefshme mund të jetë e vështirë të hapësh një llogari

Conto corrente (llogaria bankare)

Llogaria bankare është një llogari që përdoret për menaxhimin e përditshëm të parave.

Me një llogari bankare mund të:

- Marrësh pagën/rrogën
- Bësh transferta bankare
- Paguash faturat
- Tërheqësh para në dorë
- Dërgosh para

Mund të depozitosh dhe të tërheqësh para në çdo moment, por mund të ketë limite ditore.

Për të hapur një llogari bankare në Itali zakonisht kërkohet:


- Dokument identiteti i vlefshëm
- Codice fiscale (kodi fiskal)
- *Permesso di soggiorno* (leje qëndrimi) ose vërtetim aplikimi
- Residenza ose domicilio (adresë banimi)

E rëndësishme

Në Itali, të kesh një llogari bankare është shpesh e nevojshme për:

- Të punosh me kontratë të rregullt
- Të marrësh pagën/rrogën
- Të marrësh ndihma ose bonuse
- Të paguash qiranë dhe shërbimet

Ekziston dhe *conto di base* (llogaria bazë), e cila kushton më pak dhe është menduar për persona me të ardhura të ulëta.



Kujdes të dhënat personale!

Emri dhe mbiemri duhet të përputhen saktësisht me ato që janë në dokumentet zyrtare (pasaportë, leje qëndrimi, kartë identiteti)..

Edhe një ndryshim i vogël (renditje e ndryshme e emrit, emër i dyfishtë, mungesë e një theksi) mund të bllokojë një transfertë bankare ose të krijojë probleme në identifikim.

Është e rëndësishme të informoni gjithmonë bankën për çdo përditësim të dokumenteve.

Si të bësh një *bonifico* (transferte bankare)?

Për të bërë një *bonifico* nevojiten:

- Emri dhe mbiemri i përfituesit
- *IBAN* (kodi ndërkombëtar i llogarisë)
- Eventualisht *BIC/SWIFT* (për *bonifico* jashtë shtetit)
- Shuma
- *Causale* (arsyeja e pagesës, p.sh. “*affitto marzo*”)

Bonifico mund të bëhet:

- Në *filiale* (degë)
- Në bankomat (ATM)
- Online përmes home banking
- Përmes aplikacionit bankar

Një gabim në IBAN mund të vonojë ose të pengojë transferimin.

IBAN

IBAN është numri që identifikon llogarinë tënde bankare.

Shërben për:

- *Marrjen e pagës*
- *Dërgimin dhe marrjen e bonifici*
- *Kryerjen e pagesave të gjurmueshme*

IBAN identifikon llogarinë, jo personin.



SWIFT / BIC

*Është kodi që identifikon bankën.
Në pagesat ndërkombëtare shpesh është e
nevojshme të përdoren si IBAN ashtu edhe
SWIFT/BIC, për të shmangur gabime ose vonesa.*

Carte di pagamento (kartat e pagesës)

Kartat të lejojnë të paguash pa para cash.

Kur merr një kartë:

- Të jepet një PIN (mos e ndaj me askënd)
- Mund ta përdorësh në dyqane (POS) ose online
- Shumë karta janë contactless

Mos ndaj kurrë:

- Numrin e plotë të kartës
- Kodin me tre shifra (CVV)
- Foto të pjesës së pasme të kartës



Llojet e kartave

“

CARTA DI DEBITO (Kartë debiti)

- E lidhur me conto corrente
- Shpenzon vetëm paratë që ke
- Pagesa bëhet menjëherë

”

“

CARTA DI CREDITO (Kartë krediti)

- Lejon të shpenzosh para të huazuara nga banka
- Kthehen më vonë (zakonisht muajin pasardhës)
- Kërkon një situatë të mirë financiare


”

“

CARTA PREPAGATA (Kartë me parapagim)

- Ngarkohet me një shumë të caktuar
- Jo gjithmonë kërkon conto corrente
- Shpenzon vetëm aq sa ngarkon
- Shpesh më e aksesueshme për ata që sapo kanë ardhur në Itali

”



Aplikacionet bankare

Shumë banka ofrojnë një app për smartphone që lejon:

- Kontrollin e *saldo* (gjëndjes së llogaris) në kohë reale
- Kryerjen e *bonifici*
- Pagesën e faturave
- Bllokimin e kartës në rast humbjeje
- Marrjen e njoftimeve për lëvizjet



Për të përdorur app-in nevojitet një smartphone dhe shpesh një sistem sigurie shtesë (*codice OTP*, gjurmë gishti ose njohje fytyre).

Është shumë e rëndësishme të mos ndash kurrë password ose kodet e marra me SMS apo email.

Kartat mund të jenë fizike ose dixhitale (të lidhura me smartphone).

Pagesat ndërkombëtare

Nëse ke familje në një vend tjetër, mund të të duhet të dërgosh ose të marrësh para jashtë shtetit.

• **RIMESSE FORMALI** (Remitancat formale)

Janë transfertat të kryera përmes:

- Bankave
- Shërbimeve zyrtare të money transfer

Janë:

- Të rregulluara
- Më të sigurta
- Të gjurmueshme

• **RIMESSE INFORMALI** (Remitancat informale)

Bazohen në rrjete personale ose komunitare.

Mund të jenë:

- Më të shpejta
- Më fleksibile

Por:

- Nuk janë të rregulluara
- Nuk ofrojnë mbrojtje ligjore

• **MOBILE MONEY**

Është një sistem që lejon:

- Depozitim
- Dërgimin
- Marrjen e parave përmes telefonit

Është shumë i përhapur në disa vende afrikane dhe aziatike dhe është i dobishëm edhe pa llogari bankare (conto bancario).


• **PAGESAT DIXHITALE**

Pagesa përmes:

- App
- Kartave online
- Platformave dixhitale (p.sh. TapTap Send)

Përdoren gjithnjë e më shumë në Itali dhe Evropë për:

- Blerje
- Fatura
- Shërbime online





Menaxhimi i kursimeve dhe gjurmimi i shpenzimeve

Të jetosh mes dy vendeve do të thotë të mbash njëkohësisht dy realitete.

Nga njëra anë ndërton jetën në Itali (punë, shtëpi, dokumente), dhe nga ana tjetër mbetesh i lidhur me vendin e origjinës (familja, përgjegjësi, emergjenca).

Menaxhimi i parave në këtë situatë nuk është gjithmonë i lehtë.

Të mbash gjurmë të shpenzimeve nuk shërben vetëm për të ditur sa shpenzon, por për të kuptuar pse shpenzon. Kjo të ndihmon të marrësh vendime më të qeta dhe të shmangësh ankthin në fund të muajit.

Si të organizosh shpenzimet

Një mënyrë e mirë është t'i ndash në: Çfarë është e domosdoshme; Çfarë është e rëndësishme; Çfarë mund të shmanget. Nuk ka përqindje fikse: gjithçka varet nga të ardhurat dhe prioritetet e tua.

1. **Spese fisse (shpenzime fikse)** | Janë shpenzime mujore, me datë dhe shumë të qëndrueshme. Janë prioritare sepse të lejojnë të jetosh dhe të punosh rregullisht në Itali.

Bëjnë pjesë në këtë kategori:



Ushqimi dhe shpenzimet mujore



Qiraja / Kredia



Faturat, dokumentat dhe transporti

Këto shpenzime duhet t'i mbulosh menjëherë sapo merr rrogën.

2. **Spese flessibili (shpenzime elastike)** | Janë të rëndësishme për jetën e përditshme, por mund të ndryshojnë në bazë të vendimeve dhe situatës tënde mujore. Këtu mund të kursesh nëse është e nevojshme. Për shembull:



Telefoni dhe interneti



Veshjet dhe koha e lirë



Dërgesa parash për familjen

3. **Shpenzime sociale të detyrueshme** | Kjo kategori shpesh nuk përfshihet në manualët financiarë evropiane, por është shumë e rëndësishme. Lidhen me familjen dhe komunitetin dhe ruajnë marrëdhëniet dhe respektin reciprok. Përfshijnë:



Kontribute për dasma, lindje, funerale ose ngjarje të miqve/familjarëve



Ndihma të papritura për familjarë ose miq



Mbledhje fondesh komunitare

Të ardhurat: ndërtimi i një baze të sigurt

Të ardhurat mund të vijnë nga burime të ndryshme. Të kuptosh nga vijnë paratë është e rëndësishme jo vetëm për të tashmen, por edhe për të ardhmen tënde në Itali.

- **Punësim i rregullt:** baza më e fortë. Një kontratë të jep të drejta, mbrojtje, kontribute pensioni dhe mundësinë për të rinovuar dokumentet tuaja. Të ardhurat tuaja të deklaruar janë gjithashtu të rëndësishme për shtetësinë, ribashkimin familjar dhe aksesin në shërbimet sociale.
- **Subvencione dhe bonuse:** Ndhimja për fëmijë ose ndihma qeveritare mund të mbulojnë shpenzime fikse. Njohja e tyre ju ndihmon të planifikoni më mirë.
- **Ndhimja nga familja ose komuniteti:** hua ose dhurata që janë të rëndësishme në momente të vështira, por nuk konsiderohen të ardhura zyrtare.

Ku shkojnë paratë e tua?

Shpenzimet e tua tregojnë historinë dhe përgjegjësitë e tua. Ndarja e tyre të ndihmon të kuptosh se çfarë është thelbësore dhe ku mund të ndërhysh.

- Shpenzimet në Itali si shtëpia, faturat, transporti, ushqimet janë baza e sigurisë dhe dinjitetit.
- Dërgesa parash në vende të tjera, për të mbështetur fëmijët, prindërit ose për të ndërtuar një të ardhme. Nuk janë vetëm paratë që dalin nga llogaria, por edhe një investim emocional.
- Detyrimet sociale dhe familjare që mbajnë gjallë lidhjet dhe respektin.



Për ta menaxhuar më mirë paranë, duhet ta “shohësh” atë.

Zgjidh mjetin që të përshtatet më shumë.

Nëse përdor smartphone, app-et e thjeshta ndihmojnë për të kuptuar situatën mujore.

Nëse preferon një metodë tradicionale, stilolapsi dhe letra funksionon shumë mirë: ndaj një fletë letre në kolona për të ardhurat dhe shpenzimet dhe krahaso muajt.

Kjo të ndihmon të kuptosh nëse shpenzimet fleksibile po zënë shumë vend dhe nëse kanë mbetur burime të mjaftueshme për kursime dhe për familjen.

Menaxhimi i parave nuk do të thotë të heqësh dorë nga gjithçka, por të marrësh vendime të vetëdijshme duke respektuar jetën në Itali dhe rrënjët e tua. Planifikimi është themelor.



	Shpenzime thelbësore	Kulturë dhe kohë e lirë	Kënaqësitë e jetës	Ngjarje të papritura	Totali i ditës
E hënë					
E martë					
E mërkurë					
E enjte					
E premte					
E shtunë					
E diel					

Ushqim

Shëndet

Fëmijë

Transport

Shtëpi

TOT

Shfaqje

Libra

Revista

Udhëtime

Donacione

TOT

Restorante

Teknologji

Pasuri

Hobi

TOT

Riparime

Pagesa shtesë

TOT

Totali javor i përgjithshëm

4 Planifikimi financiar

Planifikimi financiar do të thotë të vendosësh paraprakisht se si t'i përdorësh paratë, në vend që thjesht të reagosh ndaj urgjencave. Nuk ke nevojë të fitosh shumë për të planifikuar. Duhet qartësi: të dish se për çfarë po kursen dhe sa shpejt dëshiron t'i përdorësh ato.



Dy lloje të ndryshme kursimesh (të dyja të nevojshme)

1. Kursime emergjente - rrjeti i sigurisë

Këto janë para të lëna mënjanë për ngjarje të papritura. Nuk përdoren për të përmbushur ëndrrat, por për të shmangur probleme serioze. Mund të jenë të dobishme në rast se:

- humbet punën, ke kujdesin e nevojshëm mjekësor ose urgjenca të papritura familjare
- Rroga vonohet

Këto kursime duhet të jenë lehtësisht të arritshme dhe të ndara nga paratë e tjera. Edhe shumat e vogla kanë rëndësi: 20 € në muaj janë më mirë se asgjë. Qëllimi është të shmangësh marrjen e kredive urgjente ose hyrjen në borxhe të shpejta.

2. Kursimi për objektiva - ndërtimi i së ardhmes

Ky kursim ka një qëllim specifik. Ti e din pse po kursen dhe kur do t'i përdorësh ato para.

Të kesh një qëllim të qartë të ndihmon të:

- shmangësh shpenzimet e panevojshme
- shpjegosh familjes pse nuk mund të dërgosh më shumë para në muaj të caktuar
- të qëndrosh i motivuar edhe kur udhëtimi është i gjatë

OBJEKTIVA TË MUNDSHME

Çdo person ka prioritete të ndryshme. Asnjë objektiv nuk është “i gabuar”.

- Dokumentat: rinovimi i lejes së qëndrimit, shtetësia, bashkimi familjar.
- Shtëpia: kapar për një qira më të mirë, blerja e një shtëpie në Itali ose në vendin e origjinës.
- Studimi: formim personal ose arsimim i fëmijëve, në Itali ose diku tjetër.
- Biznesi: fillimi i një aktiviteti të vogël, edhe ndërkombëtar.
- Kthim ose qarkullim: udhëtim, kthim i përkohshëm ose përfundimtar, ose jetë mes disa vendeve.

Shkrimi i objektivit (edhe në një fletë) e bën atë më real dhe më të arritshëm.



Horizonti kohor: kur do të të duhen paratë e tua?

Çdo objektiv ka një kohë të ndryshme. Ta kuptosh këtë të ndihmon të zgjedhësh si të kursesh.



1 Afatshkurtër (brenda 1 viti)



Dokumentat



Udhëtimet urgjente



Emergjencia të vogla



Para menjëherë,
pa rreziqe

2 Afatmesëm (1–5 vite)



Studimi



Fillimi i një aktiviteti




Blerja e shtëpisë



Kursim i rregullt

3 Afatgjatë (mbi 5 vite)



Shtëpi



Pension



Kthim / Lëvizje më e
shpeshtë mes vendeve



Durim dhe
mbrojtje e
kursimeve



Shumë persona pyesin veten si t'i përdorin paratë e tyre në mënyrë të sigurt dhe të zgjuar. Është e rëndësishme të kuptohen mirë dallimet midis kursimit, investimit dhe spekulimit, sepse çdo zgjedhje ka pasoja të ndryshme.

Dallimi mes: *risparmio* – *investimento* – *speculazione*

Risparmio (kursim)

Risparmio është para që i lë mënjanë për të ardhmen.

I mban në bankë ose në një vend të sigurt.

- Është zgjedhja më e sigurt.
- Paratë rriten ngadalë.
- Mund t'i përdorësh lehtësisht në rast emergjence.
- Kujdes: me inflacionin, vlera e parave mund të ulet me kalimin e kohës.

Shërben për të të mbrojtur nga të papriturat (sëmundje, humbje pune, shpenzime urgjente).

Investimento (investim)

Investimento do të thotë të përdorësh paratë për t'i rritur me kalimin e kohës.

- Nuk është i menjëhershëm.
- Mund të sjellë fitime më të mëdha se kursimi.
- Ka gjithmonë rrezik: mund të fitosh, por edhe të humbasësh.

Shërben për të ndërtuar stabilitet ekonomik në të ardhmen.

Speculazione (spekulim)

Spekulimi kërkon fitime të shpejta dhe të larta.

- Është shumë i rrezikshëm.
- Mund të fitosh shumë, por mund të humbasësh gjithçka.
- Shpesh kërkon eksperiencë dhe njohuri teknike.

Non è una scelta sicura per chi ha pochi risparmi.

Rreziku dhe fitimi (me shembuj të përditshëm)

- Rrezik = mundësia për të humbur para.
- Fitim = fitimi i mundshëm.

Zakonisht:

sa më i lartë fitimi i mundshëm, aq më i lartë është rreziku.

Shembull i thjeshtë:

- Të ecësh është e sigurt por e ngadaltë → si kursimi.
- Të ecësh me biçikletë është më shpejt por pak më e rrezikshme → si investimi.
- Të vraposh në mes të trafikut është shumë e rrezikshme → si spekulimi.

Zgjedhje të sigurta = rritje e ngadaltë por e qëndrueshme.

Zgjedhje me rrezik = fitime të mundshme të shpejta por edhe humbje të mëdha.

Opsione reale

Shumë persona pyesin veten si t'i përdorin paratë e tyre në mënyrë të sigurt dhe të zgjuar. Është e rëndësishme të kuptohen mirë dallimet midis kursimit, investimit dhe spekulimit, sepse çdo zgjedhje ka pasoja të ndryshme.



Biznese të vogla

Hapja ose pjesëmarrja në një aktivitet të vogël (dyqan, shërbime, restorant).

Para se të fillosh:

- Studio tregun.
- Informohu për taksat dhe dokumentet.
- Nëse punon me të tjerë, shkruaj gjithmonë një kontratë të firmosur.



Mikro-ndërmarrje

Aktivitete të vogla individuale me kosto të ulëta (zanate, shërbime shtëpiake, tregti online).

Shpesh janë më të aksesueshme për ata që fillojnë me pak kapital.




Kooperativa

Kooperativat janë ndërmarrje të menaxhuara nga një grup personash që ndajnë kostot, përgjegjësitë dhe fitimet.

In Italia sono regolate dal Ministero delle Nè Itali rregullohen nga Ministria e Ndërmarrjeve dhe Made in Italy dhe përfaqësohen nga organizata si Confcooperative dhe Legacoop.

Avantazhe:

- Rrezik i ndarë.
- Vendime kolektive.
- Mbështetje më e madhe mes anëtarëve.



Formimi profesional

Investimi në aftësitë e tua është shpesh zgjedhja më e sigurt.

Në Itali ekzistojnë programe publike të promovuara nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale dhe nga Rajonet.

Mund të përfshijë:

- kurse teknike
- aftësi dixhitale,
- gjuhë,
- kualifikime profesionale.

Fitimi nuk është i menjëhershëm, por rrit mundësitë e punës me kalimin e kohës.

KUJDES NGA MASHTRIMET!



Premtojnë fitime të larta pa rrezik.

Shenja rreziku:



“Fitim i garantuar”



Presion për të vendosur menjëherë



Kërkesë për *bonifico* urgjent



Asnjë dokument zyrtar

Premtime për fitime të shpejta



Nëse duket shumë e bukur për të qenë e vërtetë, ndoshta nuk është e vërtetë. Investimet e vërteta kërkojnë kohë.

Kujdes nga mashtrimet online!

Mashtrimi është një vepër penale e parashikuar nga Kodi Penal italian.

Nëse ndodh:

1. Denonco në Polici (numri unik 112 në emergjencë).
2. Sinjalizo online te Polizia Postale e delle Comunicazioni.
3. Kontakto menjëherë bankën tënde.
4. Mund të sinjalizosh edhe te CONSOB dhe Autorità Garante della Concorrenza e del Mercato.

Mos ndaj kurrë:

- password
- PIN
- kode OTP

Bankat nuk i kërkojnë kurrë këto informacione me telefon ose email.

6 Sigurimet dhe previdenca

Sigurimet janë një mjet financiar që të ndihmon të mbrohesh nga një humbje e rëndësishme ekonomike kur ndodh diçka e papritur.

Sigurimet funksionojnë kështu: ti paguan rregullisht një shumë parash (e quajtur premio) një kompanie sigurimi, e cila të dëmshpërblen në rast rreziku ose humbjeje të papritur.

Për shembull, mund të ndihmojë për të mbuluar kostot nëse ke një aksident rrugor ose nëse duhet të përballosh shpenzime shëndetësore.



Ekzistojnë shumë lloje sigurimesh:

Sigurimi shëndetësor

- Në Itali, shëndetësia publike garantohet nga Servizio Sanitario Nazionale (SSN).
- Sigurimet private ndihmojnë për të pasur vizita më të shpejta ose akses në klinika private.
- Ndonjëherë janë të përfshira në kontratën e punës: kontrollo gjithmonë.

Sigurimi i jetës

- Paguan një shumë periodike.
 - Nëse vdes (ose pas një periudhe të caktuar), i jepet një shumë parash personit që ke përcaktuar.
- Shërben për të mbrojtur ekonomisht familjen.

Sigurimi kundër aksidenteve

Në rast aksidenti, sigurimi mund të ofrojë mbrojtje financiare nëse pëson një dëmtim.

Kujto: në punë, punëtorët janë automatikisht të mbuluar nga sistemi kombëtar i sigurimeve (INAIL), por mbulimi zakonisht vlen vetëm për aksidentet që lidhen me punën.

Sigurimi i makinës

Në Itali, sigurimi i makinës për përgjegjësinë civile është i detyrueshëm.

Zgjidh me kujdes opsionin më të mirë për ty.

Sigurimi i shtëpisë

- Mbulon rreziqe si zjarr, vjedhje, dëme nga uji ose ngjarje natyrore.
- Nuk është i detyrueshëm, por mund të kërkohet nga banka nëse kërkon një *mutuo* (kredi hipotekare).



Sigurimet nuk shërbejnë për të fituar para: ato shërbejnë për të shmangur humbje të mëdha në rast problemesh.

Sistemi publik i pensioneve dhe i sigurisë sociale

Në Itali, sistemi publik i pensioneve menaxhohet nga **INPS**, enti publik që merret me sigurinë sociale. Kur punon, një pjesë e pagës tënde (së bashku me kontributet e paguara nga punëdhënësi) shkon automatikisht te INPS. Këto para përdoren më pas për të të mbështetur në momente të ndryshme të jetës.

Për shembull, INPS paguan pensionin kur del në pension, të ndihmon ekonomikisht nëse humb punën (**NASpI**) dhe ofron mbështetje për përfitime si leja e lindjes, sëmundja apo ndihmat familjare. Në praktikë, ti kontribuon në sistem gjatë kohës që punon dhe sistemi të ndihmon kur ke nevojë. Edhe punëtorët e vetëpunësuar dhe profesionistët e lirë, përfshirë personat me Partita IVA, duhet të regjistrohen në INPS.

Përveç pensionit publik, në Itali inkurajohet edhe aderimi në një fond pensioni plotësues (fondo pensione complementare). Këto fonde financohen shpesh përmes kontributeve private ose përmes **TFR (Trattamento di Fine Rapporto)**, që është likuidimi i akumuluar nga punëdhënësi. Duke filluar nga 1 korriku 2026, punonjësit e rinj në sektorin privat do të regjistrohen automatikisht në një fond pensioni plotësues duke përdorur TFR, përveç nëse zgjedhin shprehimisht të heqin dorë.

Nëse ndalon së punuari, mbrojtjet dhe të drejtat e tua pensionistike duhet të mbeten të garantuara. Megjithatë, duke qenë se kontributet ndërpriten, kjo mund të vonojë daljen në pension ose të ulë shumën përfundimtare të pensionit. Nëse humbja e punës është e pavullnetshme, mund të kesh të drejtë për përfitime papunësie dhe mund të kesh mundësinë të paguash kontribute vullnetare për të mbuluar periudhat që mungojnë.

Rekomandohet të kontaktosh një institut të asistencës sociale për të menaxhuar procedurën e kërkesës për përfitime ose për vazhdimin e kontributeve në rast papunësie.



Cosa succede se lascio l'Italia?

Nëse transferohesh nga Italia, ndërsa pensionet e bazuara në kontribute zakonisht mund të transferohen jashtë vendit, përfitimet asistenciale humbasin pas gjashtë muajsh qëndrimi jashtë vendit. Nëse lëviz brenda Bashkimit Evropian (BE), të drejtat e tua pensionistike mund të grumbullohen dhe të transferohen.

Është e rëndësishme që, përpara se të largohesh nga Italia të marrësh një *estratto contributivo* (ekstrakt të kontributeve) nga **INPS** për të verifikuar kontributet e paguara deri në atë moment, të regjistrohesh në **AIRE** nëse je shtetas italian, të komunikosh ndryshimin e rezidencës te institucione si *Agenzia delle Entrate* dhe banka jote.

Sigurohu që të drejtohesh te një CAF ose një institucion specifik për t'u informuar se si të transferosh kontributet e tua në vendin e destinacionit përpara se të largohesh.

HAPE SIRE INFORMUESE

Zbulo më shumë për:



**Kredi dhe
mikro-kredi**



**Huamarrja dhe
mblingarkesa me
borxhe**



**Menaxhimi i
një kredie**



Financa islame



**Përfshirja
financiare e grave**



**Aksione dhe
obligacione**



Zbulo më shumë duke lexuar dy faqet në vijim.

***Prestito* (kredi) dhe microcredito (mikro-kredi)**

***Prestito* tradicional**

Është një marrëveshje me një bankë ose institucion financiar: merr një shumë parash dhe e kthen me interes. Kërkon kujdes ndaj kostove totale dhe penaliteteve.

Microcredito

Është menduar për ata që kanë të ardhura të ulëta ose pak dokumente bankare. Shpesh shoqërohet me:

- mbështetje në menaxhim
- shuma më të vogla
- vëmendje ndaj projekteve të jetës ose punës

Është një mjet i dobishëm, por duhet gjithsesi të planifikohet.

Për më shumë informacion, vizito projektin “Monetine” të realizuar nga Fondazione Finanza Etica.

Menaxhimi i një kredie: kujdes, nuk është para “ekstra”

Një *prestito* (kredi) nuk është dhuratë: është para që i përdor sot, por i paguan nesër, shpesh me interes.

Para se të pranosh një hua, pyet veten:

- a mund ta paguaj këstin edhe nëse humbas punën?
- për sa kohë do të jem i lidhur me këtë borxh?
- është për një nevojë reale apo për të mbuluar një problem të përkohshëm?

Një hua mund të jetë e dobishme për studim, punë ose për të nisur një biznes. Bëhet e rrezikshme kur përdoret vetëm për të mbijetuar.



Huamarrja dhe mbingarkesa me borxhe

Indebitamento (huamarrje) do të thotë të kesh një detyrim që mund ta menaxhosh.

Sovraindebitamento (mbingarkesa me borxhe) do të thotë të kesh shumë borxhe krahasuar me të ardhurat.

Shenja rreziku: përdor një kredi/huamarrje për të paguar një tjetër, vonon qiranë ose faturat për të paguar këstet, jeton gjithmonë në emergjencë.

Në këto raste është e rëndësishme të kërkosht ndihmë: **CAF**, shoqata, sportele sociale ose komunitare mund të të ndihmojnë të riorganizosh situatën para se të përkeqësohet.



Financa islame (për ata që e ndjekin)

Në financën islame, interesi (**riba**) nuk lejohet. Ekzistojnë alternativa të bazuara në: ndarjen e rrezikut, blerje dhe rishitje me çmim të rënë dakord, pjesëmarrje në projekt.

Në disa vende ose në rrjete komunitare ekzistojnë forma që janë në përputhje me këto parime.

Është e rëndësishme të informohesh mirë dhe të verifikosh që janë transparente dhe të sigurta.



Përfshirja financiare e grave

Menaxhimi i financave personale është një aspekt themelor për jetën e çdo personi.

Ndër mundësitë e ndryshme, njohja dhe aftësia për të menaxhuar paratë e tua të lejon:

- **të zgjedhësh** dhe **të planifikosh** në mënyrë të pavarur
- **të marrësh pjesë** në vendimet ekonomike të familjes tënde

Aksione dhe obligacione

- **Aksionet** përfaqësojnë një pjesë pronësie në një kompani dhe vlera e tyre mund të rritet ose të ulet.
- **Obligacionet** janë një hua që i jepet një kompanie ose shtetit, i cili premtan të kthejë paratë me interes.

Në përgjithësi, aksionet janë më të rrezikshme, por mund të japin fitime më të mëdha, ndërsa obligacionet janë më të qëndrueshme, por japin më pak fitim.



Po kërkon informacion të besueshëm, falas dhe në disa gjuhë rreth jetesës në Itali? **ItaliaHello** ofron burime të përditësuara në gjashtë gjuhë mbi punën, lejen e qëndrimit, shkollën, shëndetësinë dhe shumë të tjera. Do të gjesh udhëzues praktikë dhe artikuj të qartë për t'u orientuar hap pas hapi.

Sito web: <https://italiahello.it>

Email: info@italiahello.it

Facebook e Instagram: @italiahello.it



Nosotras Onlus ofron pritje, këshillim ligjor dhe social, kurse të gjuhës italiane dhe mbështetje për gratë, veçanërisht për emigrantet. Promovon autonominë, të drejtat dhe përfshirjen përmes shërbimeve falas dhe projekteve në territor.

Sito web: <https://www.nosotras.it>

Email: info@nosotras.it

Facebook e Instagram: @nosotras_aps



ACISJF Firenze ofron strehim të përkohshëm dhe mbështetje për gra dhe vajza, italiane dhe të huaja, në situata vështirësie.

Ofron orientim social, mbështetje edukative dhe ndihmë në rrugën drejt pavarësisë.

Sito nazionale: <https://www.acisjf.it>

Email: acisjf.firenze@gmail.com

Facebook e Instagram: acisjf_firenze_odv



Me kontributin e

FONDAZIONE
IL CUORE SI SCIoglie